



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 542 Akti

Nr. 531 Vendimi  
Tiranë, më 13.5.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Relatore</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Stiven Kessler, në datën 12.5.2022, në orën 14:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Etien Kapo**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, i pranishëm në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH” dhe “E”, të Aneksit të Kushtetutës;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, analizoi provat shkresore të administruara gjatë hetimit, si dhe ato të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të rezultateve të hetimit, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Z. Etien Kapo është subjekt rivlerësimi për shkak të pozicionit si prokuror, aktualisht me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Bazuar në pikën 4, të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën

15.6.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1.

2. Në vijim, anëtarët deklaruan lidhur me konfliktin e interesit dhe caktuan kryesuese komisioneren Genta Tafa (Bungo). Vëzhgues ndërkombëtar për këtë çështje është caktuar z. Stiven Kessler.

3. Gjatë procesit të rivlerësimit është njoftuar subjekti për përbërjen e trupit gjykues, i cili ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

5. Në bazë të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet adresës elektronike, nga ku ka rezultuar se ka qenë bashkëpunues dhe ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar, si dhe janë mbledhur nga Komisioni informacione të nevojshme për hetimin, sipas nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilave, trupi gjykues ka vendosur mbi rezultatet e hetimit për subjektin rivlerësues.

6. Në datën 4.5.2022, trupi gjykues vendosi: (a) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit Etien Kapo, bazuar në tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (b) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (c) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, paraqiti shpjegime dhe dokumentacion provues lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, të cilat u administruan nga trupi gjykues për t'u vlerësuar në raport me vendimmarrjen përfundimtare.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

8. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit Etien Kapo, në seancë dëgjimore, në datën 12.5.2022, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 12.5.2022, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Stiven Kessler. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në këtë seancë dëgjimore, në përfundim të së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

10. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) informacionin e përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- ç) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, së bashku me materialin shoqërues;

- d) dokumentet shkresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- dh) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik dhe dokumentacionin provues shoqërues;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe dokumentacionin provues shoqërues;
- ë) denoncimet nga publiku dhe dokumentacionin për verifikimin e tyre, të mbledhur gjatë hetimit;
- f) shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit të dhëna gjatë seancës dëgjimore.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

11. ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, konstaton për subjektin Etien Kapo, si vijon:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e saj;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

12. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar sa më poshtë.

**13. Apartament banimi**, me sipërfaqe prej 128.6 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në \*\*\*, Tiranë, blerë sipas Kontratës së Shitblerjes, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.5.2013. Burim i krijimit të kësaj pasurie sipas Deklaratës *Vetting* janë të ardhurat në shumën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) euro, e përfituara si dhuratë nga babai i personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit (vjehtëri) si dhe të ardhurat e mbledhura nga pagat e bashkëshortëve.

13.1 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 lidhjen e Kontratës së Sipërmarrjes të datës 20.4.2007, për porositjen e një apartamenti banimi me vendndodhje në rrugën “\*\*\*”, me vlerë 85.764 (tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, me pjesë takuese 50%.

13.2 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2015 pronësinë mbi këtë apartament banimi me sipërfaqe 128.6 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*”, pjesë takuese 50% dhe me burim dhurimi me vlerë 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) euro, prej vjehtërit të tij.

13.3 Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dosjen e ILDKPKI-së rezulton se me Kontratën e Sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.4.2007, subjekti rivlerësimit ka porositur një apartament banimi me sipërfaqe banimi 78.87 m<sup>2</sup>, sipërfaqe të përbashkët prej 18.65 m<sup>2</sup>, verandë me sip. 50 m<sup>2</sup> dhe total sipërfaqe ndërtimi prej 147.52 m<sup>2</sup>, në vlerën 85.764 (tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, i cili do të ndërtohej nga shoqëritë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*” sh.p.k. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur në ILDKPKI<sup>1</sup>, në vitin 2016, ka shpjeguar se pagesa e vlerës së apartamentit është bërë *cash*.

13.4 Dega Vendore e ASHK-së, Tiranë Rurale 1 ka konfirmuar<sup>2</sup> për Komisionin pronësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij mbi këtë pasuri, nga e cila rezulton si vijon:

- a) Në datë 29.6.2012, kjo pasuri është (nr. \*\*\*) është rregjistruar në emër të shoqërsë ndërtuese “\*\*\*” sh.p.k.
- b) Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë nënshkruar Kontratën e Shitblerjes për Pasurinë e Paluajtshme me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.5.2013, apartament banimi, me sipërfaqe 128.6 m<sup>2</sup>, me palë shitëse shoqërinë ndërtuese “\*\*\*”<sup>3</sup> sh.p.k.

<sup>1</sup>Shihni përgjigjen nr. \*\*\* në procesverbalin e ILDKPKI-së.

<sup>2</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2020, të ASHK-së.

<sup>3</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

c) Në datën 17.2.2016 pasuria me sipërfaqe 128.6 m<sup>2</sup> me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes (pasuria me nr. \*\*\*, me sipërfaqe 23 m<sup>2</sup>, si pjesë përbërëse e pasurisë me sipërfaqe 128.6 m<sup>2</sup>).

13.5 Lidhur me mospërputhjen e sipërfaqes së pasurisë midis kontratës së shitblerjes (128.6 m<sup>2</sup>) dhe kontratës së sipërmarrjes (147.5 m<sup>2</sup>), në përgjigje të procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja<sup>4</sup>, subjekti i rivlerësimit shprehet se: *“Siç rezulton sipas kontratës së sipërmarrjes dhe më pas kontratës së shitjes së bashku me certifikatën e vërtetimit të pronësisë unë jam pronar i ligjshëm i sipërfaqes prej 128.6 m<sup>2</sup>, kjo sipërfaqe ndahet në sip. 78.87 m<sup>2</sup> sipërfaqe banimi dhe sip. 50 m<sup>2</sup>, verandë. Shuma e tyre përbën sipërfaqen totale prej 128.87 m<sup>2</sup>. Pra, nuk kam shtim ose pakësim të sipërfaqes totale nga ajo që unë kam blerë”.*

13.6 Komisioni ka kërkuar informacion në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me çështje penale të hetuara me shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjja<sup>5</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për subjektin e rivlerësimit.

### **Burimi i të ardhurave të përdorura për blerjen e kësaj pasurie**

13.7 Subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2007, deklaroi se burimi i të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie është dhurimi i shumës 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) euro nga babai i bashkëshortes (vjeçrri) dhe 764 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro të ardhura nga pagat. Nëpërmjet Deklaratës Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.6.2009, shtetasi Th. K. deklaroi se në prill të vitit 2007 i ka dhuruar vajzës së tij, shtetases M. K., shumën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) euro, për t’i përdorur për blerjen dhe kompletimin e shtëpisë, duke deklaruar se burimi i të ardhurave për këtë shumë vjen nga të qenurit aksioner i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a.

13.8 Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur<sup>6</sup> pyetësorit standard si dokumentacion provues për burimin e pagesave të dy kësteve të apartamentit, lëvizjet e llogarive bankare të shtetasi Th. K., në NBG dhe “Tirana Bank”, si dhe deklaratën nga ky shtetas, ku deklaroi se: *“... fondet për blerjen e shtëpisë së vajzës sime, por edhe ato për blerje të objekteve të tjera, janë tërhequr nga llogaritë në lekë/valutë që unë kam pasur, por edhe që kam në bankat e nivelit të dytë, përkatësisht si vijon:*

a) *Për këstin 51.000 euro i paguar në datën 20.4.2007, fondet janë tërhequr si vijon: (i) shuma 30.000 (tridhjetë mijë) euro është tërhequr në datën 15.12.2006, në NBG; (ii) shuma 10.000 (dhjetë mijë) euro është tërhequr në datën 20.4.2007, në NBG; si dhe (iii) shuma 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro është tërhequr në datën 10.4.2007, nga ‘Tirana Bank’.*

b) *Për këstin 34.764 (tridhjetë e katër mijë shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro i paguar në datën 15.6.2007, fondet janë tërhequr si vijon: (i) shuma 5.200 (pesë mijë e dyqind) euro është tërhequr në datën 11.4.2007, në ‘Tirana Bank’; (ii) shuma 30.000 ((tetëdhjetë mijë) euro është tërhequr në datën 14.6.2007, në NBG”.*

13.9 Sipas vërtetimit<sup>7</sup> nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2016, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, konfirmohet se shtetasi Th. K. ka përfutur si aksioner i kësaj shoqërie në formë dividendi, për periudhën 3.2.1999 – 31.12.2002, shumën prej 15.881.471 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekë.

13.10 Nga verifikimi në QKB<sup>8</sup> rezulton se shtetasi Th. K. figuron të ketë qenë ortak me 10% të kuotave në shoqërinë “\*\*\*\*” sh. a., prej vitit 1998 dhe është larguar si ortak i kësaj shoqërie në datën 19.1.2008. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. është regjistruar si person juridik me vendimin nr. \*\*\*, datë 30.12.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kapital themeltar 30.000.000

<sup>4</sup>Shihni përgjigjen nr. \*\*\* në procesverbalin e ILDKPKI-së.

<sup>5</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>6</sup>Shihni dokumentacionin bashkëlidhur në pyetësorit standard.

<sup>7</sup>Dokument i depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI.

<sup>8</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.6.2017, të QKB-së për ILDKPKI-në.

(tridhjetë milionë) lekë të ndarë me përqindje sipas numrit të aksioneve, sipas themeluesve, ku, ndër ndër ta, është edhe shtetasi Th. K.. Sipas aktit të themelimit të kësaj shoqërie shtetasi Th. K. zotëron 10% të aksioneve, të cilat konvertohen në vlerën 3.000.000 (tre milionë) lekë.

13.11 Nga korrespondenca me Komisionin, shoqëria tregtare “\*\*\*\*” sh.a. ka informuar<sup>9</sup> se shtetasi Th. K. ka përfituar shumën *neto* prej 15.881.471 (pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e shtatëdhjetë e një) lekë si dividend për periudhën 1999 – 2002 dhe se tatimi mbi dividendin është paguar prej saj për të gjithë aksionerët përfitues.

13.12 Subjekti ka deklaruar se burimet e fondeve të dhëna nga vjehri vijnë nga të ardhurat e tij në NBG dhe “Tirana Bank”, përkatësisht në vlerat 70.000 (shtatëdhjetë mijë) euro dhe 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro.

13.13 Nga verifikimi i lëvizjeve në llogaritë bankare të shtetasit Th. K. në sistemin bankar (si “Tirana Bank”, “ProCredit Bank”, NBG dhe “Raiffeisen Bank”), për periudhën 2000 – 2007, rezulton se kanë qarkulluar shuma të konsiderueshme fondesh në monedhat dem/euro dhe lekë, të cilat shpesh vinin edhe nga llogaria e tij në Greqi. Konkretisht:

a) Nga veprimet e lëvizjeve së llogarisë bankare në NGB, të shtetasit Th. K. ka rezultuar se ka tërhequr: (i) më 15.12.2006, vlerën 30.000 (tetëdhjetë mijë) euro, e cila është kredituar në llogarinë e tij me transfertë bankare nga jashtë në datën 12.12.2006; (ii) më 20.4.2007, vlerën 10.000 (dhjetë mijë) euro, e cila është depozituar *cash* prej tij në datën 18.4.2007; (iii) më 14.6.2007, vlerën 30.000 (tetëdhjetë mijë) euro, e kredituar në llogari me transferte bankare nga jashtë në datën 12.6.2007.

b) Nga lëvizjet e llogarisë bankare në “Tirana Bank” të shtetasit Th. K. rezulton se ky shtetas ka tërhequr në datën 10.4.2007 shumën 14.000 (katërmëdhjetë mijë) euro dhe në datën 11.4.2007 shumën 5.000 (pesë mijë) euro. Këto shuma monetare kanë qenë depozitë bankare në “Tirana Bank”, të krijuara ndër vite.

13.14 Nga hetimi ka rezultuar se z. Th. K. ka pasur likuiditete në bankë, të cilat rezultojnë se janë tërhequr gjatë periudhës prill - qershor 2007. Këto të ardhura kanë rezultuar me burime të ligjshme nga aktiviteti i tij tregtarë.

13.15 Lidhur me të ardhurat në shumën 764 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër) euro, ka rezultuar nga analiza financiare se bashkëshortët kanë mundësi financiare me burime të ligjshme deri në qershor të vitit 2007 për të kursyer këtë shumë.

13.16 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzime për arredimin dhe punimet e kryera në shtëpi (për pjesën e verandës), të cilat janë përfshirë në analizën financiare të Komisionit.

13.17 Në përfundim, pas verifikimeve, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri. Nga hetimi ka rezultuar se për shumën e dhuruar janë përmbushur kërkesat e nenit 32 pika 4 të ligjit nr. 84/2016 e se ato plotësojnë kërkesat e nenit D pika 3 të Aneksit të Kushtetutës.

**14. Rikonstruksion i pjesshëm i ballkonit të apartamentit të banimit, me sipërfaqe 23 m<sup>2</sup>, në periudhën 2008 – 2013, në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë. Burimi i krijimit: kursimet e përbashkëta familjare.**

14.1 ASHK-ja ka konfirmuar<sup>10</sup> për Komisionin se subjekti i rivlerësimit është pajisur me Lejen e Legalizimit nr. \*\*\*, datë 29.8.2013, për rikonstruksionin e sipërfaqes ndërtimore prej 23 m<sup>2</sup> në verandën ekzistuese. Sipas kartelës së pasuri kjo sipërfaqe figuron e regjistruar në datën 2.9.2013 në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes. Referuar dokumentacionit në dosjen e legalizimit të depozituar nga ALUIZNI<sup>11</sup> për ILDKPKI-në rezulton se vetëdeklarimi

<sup>9</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2022, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., bashkëlidhur së cilës gjendet vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2016 për shumën e përfituar nga dividendi, vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 10.1.2020, për të ardhurat e realizuara si punonjës, si dhe kopje e vendimit nr. \*\*\*, datë 30.8.2007, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbi “Miratimin e pjesëmarrjes = influencese të TBH (75%+1) në shoqërinë e sigurimit “\*\*\*\*” sh.a., si dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2022.

<sup>10</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2020, të ASHK-së.

<sup>11</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.8.2017, të ALUIZNI-t.

për këtë rikonstrukcion është bërë në datën 12.7.2013. Ndërtimi është bërë për të gjithë banorët e pallatit dhe legalizimi është bërë për të gjithë njësinë.

14.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar<sup>12</sup> se ky ndërtim është pjesë e apartamentit të banimit të blerë nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes në vitin 2007. Sipas kësaj kontrate, sipërfaqja e shfrytëzimit prej 126.8 m<sup>2</sup> ndahet në sipërfaqe banimi prej 78.87 m<sup>2</sup> dhe 50 m<sup>2</sup> verandë. Ndërtimi me sipërfaqe prej 23 m<sup>2</sup>, realizuar te veranda, është pjesë e pandarë e sipërfaqes totale të apartamentit prej 126.8 m<sup>2</sup>.

14.3 Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shpenzimet për këtë investim, kryer deri në vitin 2013.

14.4 Në përfundim, pas verifikimeve, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri.

**15. Pasuria automjet tip “Skoda Roomster”, vit i prodhimit 2008, me targa \*\*\* (\*\*\*)<sup>13</sup>, blerë në vlerën 15.150 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Volkswagen”, me targa \*\*\*, në pronësi të subjektit deklarues; të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa”, me targë \*\*\*, në pronësi të bashkëshortes M. K. (Kapo), si dhe të ardhurat e grumbulluara nga pagat mujore të subjektit deklarues dhe të bashkëshortes së tij.**

15.1 DPSHTRR-ja ka konfirmuar<sup>14</sup> për Komisionin se automjeti me targë \*\*\* (\*\*\*) është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit duke përcjellë edhe dosjen e automjetit.

15.2 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton:

a) Automjeti tip “Skoda Roomster”, vit i prodhimit 2008, është blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. në republikën çeke me palë shitëse shoqërinë “\*\*\*\*” dhe sipas faturës datë 20.8.2008, e lëshuar nga kjo shoqëri, çmimi i blerjes është 11.053 (njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e tre) euro.

b) Sipas deklaratës doganore, ky automjet është zhdoganuar në datën 8.9.2008 nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe detyrimi doganor i paguar është në vlerën 269.029 (dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e njëzet e nëntë) lekë.

c) Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet Faturës Tatimore të Shitjes nr. \*\*\*, datë 2.6.2009, e ka blerë këtë automjet kundrejt vlerës 15.150 (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro (ekuivalent në 2.006.920 lekë).

15.3 Sipas DPP-së<sup>15</sup> rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer pagesën prej 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro në “Raiffeisen Bank” në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

### **Lidhur me burimin për krijimin e pasurisë**

15.4 Të ardhurat e grumbulluara nga shitja e automjetit tip “Volkswagen”, me targa \*\*\*, në pronësi të subjektit të rivlerësimit, si në vijim:

a) Në DPV-në e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Volkswagen”, në vlerën 490.000 (katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë me burim të ardhurat e tij nga dy vjet emigracion dhe nga puna.

b) Në DPV-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e këtij automjeti me Kontratën e datës 18.5.2009, në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro.

15.5 Të ardhurat e grumbulluara nga shitja e automjetit tip “Opel Corsa”, me targa \*\*\*, në pronësi të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit (bashkëshortja), si në vijim:

<sup>12</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2021, të ILDKPKI-së.

<sup>13</sup>Shihni përgjigjen nr. \*\*\* të procesverbalit të datës 5.2.2016, të ILDKPKI-së, ku deklarohet se ka bërë zëvendësimin e targës së automjetit nga \*\*\* në \*\*\*, duke u pajisur edhe me certifikatën e pronësisë.

<sup>14</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020, të DPSHTRR-së.

<sup>15</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.9.2020.

a) Në DPV-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerjen e automjeti tip “Opel Corsa” nga bashkëshortja gjatë vitit 2006 (para martese me subjektin), në vlerën 4.500 (katër mijë e pesëqind) euro.

b) Në DPV-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e automjetit në datën 23.4.2009, në vlerën 400.000 (katërqind mijë) lekë.

15.6 Të ardhurat e grumbulluara nga pagat. Subjekti i rivlerësimit deklaroi në Deklaratën *Vetting* se si burim për blerjen e kësaj pasurie kanë shërbyer edhe të ardhurat familjare të grumbulluara nga pagat e tij dhe të bashkëshortes, të cilat janë në shumën 1.000.000 (një milion) lekë.

15.7 Në përfundim të verifikimeve për këtë pasuri ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Skoda Roomster”, në vitin 2009, në vlerën 2.006.920 (dy milionë e gjashtë mijë e nëntëqind e njëzet) lekë.

Çmimi i shitjes së automjetit tip “Volkswagen”, në vitin 2009, në vlerën 5.000 (pesë mijë) euro (ekuivalent në 685.850 lekë) është më i lartë se çmimi fillestar i blerjes prej 490.000 (katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë, i deklaruar në kontratën e shitblerjes nga subjekti i rivlerësimit.

15.8 Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit.

15.9 Në përgjigje të rezultatit të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vlera e automjetit nga viti 2003 deri në vitin 2009 është rritur për shkak të investimeve në mirëmbajtje, ndër vite, duke e bërë automjetin të përdorshëm edhe në ditët e sotme. Konkretisht, investimet konsistojnë në: lyerjen tërësore të automjetit; pajisjen me goma të reja për shkak të amortizimit të atyre të mëparshme; ndërrimin e tapicerisë; vendosjen e sistemit të alarmit; si dhe në investimin që i është bërë lidhur me riparimin e sistemit të ajrit kondicionuar. Të gjitha këto investime të kryera nuk tejkalojnë shumën 220.000 (dyqind e njëzet mijë) lekë në vite dhe investimet janë bërë brenda periudhës së viteve 2004 – 2008. Gjithashtu, shitja i është përgjigjur investimeve në mjet dhe vlerës së tregut të këtij automjeti në periudhën e shitjes. Për shkak të fragmentarizmit të punimeve në vite dhe kohës së largët, nuk disponohen fatura.

15.10 Në përfundim, pas vlerësimit, trupi gjykues i Komisionit çmon se problematika e konstatuar mes diferencës së çmimit të shitjes dhe atij të blerjes, megjithëse është një tregues që ngre dyshime se çmimi i blerjes ose ai i shitjes nuk janë deklaruar saktësisht, vlera relative për të cilën bëhet fjalë nuk është e tillë që të vlerësohet si shkak penalizues për subjektin e rivlerësimit.

**16. Depozitë bankare, në vlerën 833.66 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë, në “Intesa Sanpaolo Bank”, në emër të subjektit të rivlerësimit.** Burimi i krijimit: kursimet personale dhe të ardhurat vjetore të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë<sup>16</sup> mandatin e Bankës Amerikane të vitit 2002, ku është çelur një depozitë bankare në shumën 4.000 (katër mijë) USD, më 8.1.2002.

16.1 “Intesa Sanpaolo Bank” (ish-Banka Amerikane) ka konfirmuar depozitën bankare në emër të subjektit të rivlerësimit prej vitit 2002 deri në vitin 2018, kur shuma është tërhequr nga subjekti. Nga historiku rezulton se kjo depozitë është rinovuar çdo vit duke u shtuar në vlera të ulëta nga kapitalizimi i interesit të saj.

16.2 Subjekti i rivlerësimit, nga analiza financiare e përgatitur nga njësi e shërbimit ligjor, rezultoi se ka mundësi financiare me burime të ligjshme për krijimin e kësaj depozite.

16.3 Në përfundim, pas verifikimeve, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë pasuri.

**17. Bashkëkredimarrës në një Kontratë Kredie Bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.7.2013, në vlerën 3.250.000 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me kredimarrës babain e subjektit**

<sup>16</sup>Shihni seksionin 4/4 në ILDKPKI.

17.1 Babai i subjektit të rivlerësimit, nga hetimi i zhvilluar nga Komisioni, ka rezultuar se gëzon statusin e ish-qiramarrësit në ish-pronë private dhe në zbatim të udhëzimit nr. \*\*\*, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar), ka dorëzuar pranë Entit Kombëtar të Banesave dokumentacionin ligjor për të përfituar dhe për t’u trajtuar nga kreditimi me kushte lehtësuese me 0% interes.

17.2 Në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit në pyetësin standard<sup>17</sup> nënshkrimi i kontratës së kredisë nga ana e tij është bërë për të garantuar shlyerjen e detyrimeve nga ana e babait i tij, i cili në periudhën e përfitimit të kësaj kredie ishte në moshë madhore.

17.3 Enti Kombëtar i Banesave ka konfirmuar<sup>18</sup> përfitimin dhe trajtimin me kredi lehtësuese të shtetasit P. K., duke përcjellë edhe dokumentacionin e disponuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të EKB-së rezulton se:

a) Bashkia Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.9.2009, ka informuar shtetasin P. K. se emri i tij është pjesë e listës së familjeve të pastreha me status ish-qiramarrës në ish-pronë private, e cila i është përcjellë EKB-së me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.8.2007, për trajtim.

b) Shtetasi P. K. ka dorëzuar në EKB, në datën 17.8.2010, aplikimin dhe dokumentacionin për të përfituar nga programi i kreditimit me kushte lehtësuese si ish-qiramarrës në ish-pronë private. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga ky shtetas, rezulton se në Certifikatën Familjare të vitit 2009 figuron në gjendje civile vetëm me bashkëshorten.

c) EKB-ja, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2010, informon shtetasin P. K. se emri i tij është përcjellë në BKT për përfitim kredie me 0% interes dhe afat shlyerje 30-vjeçar, duke bashkëlidhur edhe aneksin e planit të pagesave.

ç) Në vijim, është nënshkruar Kontrata e Kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.7.2013, me kredidhënës BKT-në dhe kredimarrës subjektin e rivlerësimit, bashkëshorten dhe babanë e tij, shtetasin P. K., për vlerën 3.250.000 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, me interes 0%.

d) Sipas *statement*-it bankar<sup>19</sup> të BKT-së, shtetasi P. K., pas disbursimit të vlerës së kredisë të përfituar si ish-qiramarrës në ish-pronë private, ka transferuar nëpërmjet BKT-së në datën 1.8.2013, në emër të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., vlerën 3.250.000 (tre milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe, në vijim, ka paguar rregullisht këstet mujore të kredisë me derdhje *cash* prej tij.

17.4 ILDKPKI-ja<sup>20</sup> ka përcjellë në Komision shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, së bashku me dokumentacionin përkatës, të mbajtur në procesverbalin e datës 5.2.2016. Subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga ILDKPKI-ja, ka shpjeguar se në vitin 1992 janë vënë në dijeni se vila ku banonin i ishte kthyer ish-pronarit nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe, sipas ligjit të kohës, u regjistruan si të pastrehë<sup>21</sup>. Subjekti shpjegon se janë shpërngulur familjarisht nga banesa e tyre rreth viteve 1998-1999, pasi e gjithë prona i është kthyer fizikisht pronarëve, ku këta të fundit, pas daljes së të gjithë banorëve të ndërtesës, kanë kryer një investim mbi atë sipërfaqe toke duke rrëzuar banesën, ku subjekti jetonte me familjen.

17.4.1 Në këto rrethana, për të bërë të mundur lirim të banesës brenda datës 10.2.1999, është nënshkruar Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.1999, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., nëpërmjet së cilës vërtetohet marrja e huas në vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) USD, nga babai i subjektit të rivlerësimit, me qëllim blerjen e një apartamenti prej shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Sipas kësaj deklarate noteriale, vlera e huazuar do t’i shlyhej shoqërisë “\*\*\*\*”

<sup>17</sup>Shihni përgjigjen nr. 19 në pyetësin e datës 31.8.2020.

<sup>18</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.10.2021, të Entit Kombëtar të Banesave.

<sup>19</sup>Shihni dokumentacionin bashkëlidhur procesverbalit të ILDKPKI-së.

<sup>20</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2021, të ILDKPKI-së.

<sup>21</sup>Konkretisht, ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar), përcaktonte se banesat shtetërore ish-pronë private nuk mund të privatizoheshin në bazë të këtij ligji dhe qytetarëve të konsideruar si të pastrehë u linte e drejta që për zgjidhjen e problemit të strehimit të tyre të merrnin kredi nga institucionet përkatëse.



sh.p.k. në llogarinë e saj bankare në momentin që babai i subjektit të rivlerësimit do të trajtohej dhe do të përfitonte nga statusi si i pastrehë.

17.4.2 Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur, ndër të tjera, si dokumentacion provues: (a) Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 15.2.1999; (b) Kontratë Shitblerjeje e Pasurisë së Paluajtshme nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 28.2.2013; (c) Kontrate Kredie Bankare nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 13.7.2013; (d) ekstrakt bankar datë 4.2.2016, nga BKT-ja.

17.5 Referuar shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, legjislacioni i kohës, konkretisht, ligji nr. 8030, datë 15.11.1995, “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, i ndryshuar (aktualisht i shfuqizuar), parashikonte që çdo familje e pastrehë mund të përfitonte një shumë të ardhurash nga shteti që do të përdorej për zgjidhjen e problematikës së strehimit.

17.6 Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm rezultoi se:

a) Babai i subjektit të rivlerësimit ka nënshkruar Kontratën e Sipërmarrjes datë 12.1.1999, me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. për porositjen e një apartamenti banimi në objektin që do të ndërtohej nga pala sipërmarrëse. Në këtë kuadër është lëshuar Deklarata Noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.1999, nëpërmjet së cilës shtetasi P. K. deklaroi se për të bërë të mundur lirimin e banesës ku banon, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka dhënë hua vlerën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) USD. Në këtë deklaratë noteriale shtetasi P. K. ka deklaruar se: *“Me këtë shumë dhe me një shtesë të bërë prej meje unë kam prenotuar një apartament në një ndërtim të ri me sip.128 m<sup>2</sup> pranë shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. Për të shlyer kontributin financiar të shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. në blerjen e apartamentit të mësipërm, unë detyrohem që kredinë, apartamentin apo çdo zgjidhje tjetër që shteti do më japë si i pastrehë do t’ia kaloj shoqërisë ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. në llogarinë e saj bankare”*.

b) Kontrata e Shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.2.2013, është nënshkruar nga pala shitëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe pala blerëse shtetasi P. K. për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 121.68 m<sup>2</sup>, në vlerën 37.800 (tridhjetë e shtatë mijë e tetëqind) USD. Në këtë kontratë përcaktohet se kryerja e pagesës së çmimit të apartamentit ka përfunduar në vitin 2002.

17.7 ASHK-ja ka konfirmuar<sup>22</sup> për Komisionin se apartamenti është regjistruar në emër të prindërve të subjektit të rivlerësimit sipas Certifikatës së Pronësisë datë 11.3.2013.

17.8 Në përfundim, pas verifikimeve, Komisioni nuk konstatoi problematika për këtë marrëdhënie financiare të subjektit të rivlerësimit.

**18. Pasuria tokë arë me sipërfaqe 970 m<sup>2</sup>**, e tjetërsuar, me vendndodhje në fshatin \*\*\*, Tiranë (deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën *Vetting*, në sektorin të dhëna konfidenciale)

18.1 Nga verifikimi i dokumentacionit dhe deklarimeve periodike, rezultoi se pasuria është përfituar nga subjekti i rivlerësimit prej shtetasit F. D., nëpërmjet Kontratës së Dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.11.1998. Në vijim është tjetërsuar pronësia e kësaj pasurie nga subjekti i rivlerësimit, i cili me Kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2015, ia ka dhuruar shtetas D. K..

18.2 ASHK-ja ka konfirmuar<sup>23</sup> për Komisionin pasurinë e llojit “arë + truall” me sipërfaqe 970 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të në emër të znj. D. K.. Kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, sipas Certifikatës së Pronësisë datë 26.11.1998. Subjekti i rivlerësimit<sup>24</sup>, nëpërmjet Kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2015, ia ka dhuruar pa kundërshtim pasurinë truall me sipërfaqe 970 m<sup>2</sup> shtetas D. K., e cila e ka regjistruar duke paguar edhe tatimin në vlerën 33.615 (tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, në datën 26.1.2015, nëpërmjet “Credins Bank”. Shtetasja D. K. ka aplikuar për legalizimin e një objektit<sup>25</sup> me sipërfaqe 99.3 m<sup>2</sup>, që ndodhet mbi pasurinë e llojit “arë” dhe është pajisur me Lejen e Legalizimit nr. \*\*\*, datë 27.3.2015.

<sup>22</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2020, e ASHK-së.

<sup>23</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.12.2021, e ASHK-së Tirana Rurale 1.

<sup>24</sup>Shihni pyetësorin e datës 25.10.2021, ku subjekti deklaroi se nuk e ka rivlerësuar pronën dhe as ka investuar në të.

<sup>25</sup>Ky objekt ka qenë ekzistues, faktuar sipas genplanit bashkëlidhur Certifikatës së Pronësisë datë 2.10.1998.

18.3 Lidhur me dhurimin e kësaj pasurie shtetases D. K., subjekti i rivlerësimit shpjegon<sup>26</sup>: “Nisur nga lidhjet e ngushta familjare që familja ime e origjinës kishte me këtë shtetase, nga fakti se unë dhe familja ime nuk kishim ndërmend të kryenim asnjë investim mbi sipërfaqen prej 970 m<sup>2</sup>, apo të zhvillonim pronën, si dhe nga fakti se kjo shtetase kishte ndërtimin e saj në një pjesë të kësaj pasurie, nëpërmjet Kontratës së Dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.1.2015, kam vendosur t’ia dhuroj këtë sipërfaqe toke shtetases D. K.. Qëllimi i dhurimit të kësaj toke ishte që kjo shtetase, e cila kishte në pronësi edhe ndërtimin mund ta shfrytëzonte atë në shërbim edhe të banimit”.

18.4 Subjekti i rivlerësimit thekson se gjatë gjithë periudhës së zotërimit të kësaj pasurie prej tij dhe nga asnjë person tjetër nuk është kryer asnjë ndërtim, investim, apo zhvillim infrastrukturual dhe se nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga kjo pasuri për asnjë çast.

18.5 Komisioni ka hetuar lidhur me kontrata të mundshme investimi apo ndërtimi apo leje ndërtimi mbi këtë truall, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna se shtetasit P. dhe D. K. të kenë kryer veprime noteriale apo veprime të tjera në lidhje me këtë pronë.

18.6 Në përfundim konstatohet se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit përputhen me dokumentacionin e disponuar. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni nuk ka konstatuar problematika.

**19. Të dhëna nga sistemi TIMS, të deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard** (rezultuar disa udhëtime të përbashkëta me automjete të shtetasve me të cilët udhëtonin)

19.1 Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit për njërin prej udhëtimeve dhe në përgjigjen e pyetësonit, datë 2.11.2021, ka shpjeguar<sup>27</sup> se: “Në datën 14.3.2009, unë kam udhëtuar me këtë mjet në cilësinë e pasagjerit, pra, automjeti nuk drejtohej nga unë. Unë kam udhëtuar së bashku me shtetasin A. A. (drejtuesin e mjetit), bashkëshorten time M. K. dhe djalin tonë J. K.. Udhëtimi është bërë brenda ditës nga pika e kalimit kufitar Qafë Thanë dhe, konkretisht, kemi shkuar në Ohër, Maqedoni. Udhëtimi është bërë për shkak se mjeti i shtetasit A. A. ishte i pajisur me siguracion për dalje jashtë shtetit dhe mjeti im në këtë kohë nuk ishte pajisur me një siguracion të tillë. Shtetasi A. A. është i njohuri im”.

19.2 Komisioni ka kërkuar informacion prej Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>28</sup> nëse nga subjekti i rivlerësimit janë hetuar çështje penale me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe shtetasin A. A.. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka informuar<sup>29</sup> Komisionin për verifikimin e kryer, nga ku nuk kanë rezultuar të dhëna për subjektin e rivlerësimit.

19.3 Komisioni ka verifikuar të gjitha udhëtimet e tjera të kryera nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat nuk kanë rezultuar dyshime apo indicje për hetime të mëtejshme.

19.4 Në përfundim të verifikimeve, Komisioni nuk ka konstatuar problematika.

## **20. Analiza financiare**

20.1 Bazuar në dokumentacionin e disponuar dhe deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, nga Komisioni u krye analiza paraprake e treguesve financiarë për periudhën 2003 – 2016, si dhe analiza financiare në mënyrë kumulative deri në vitin 2003, duke marrë në analizimin e likuiditeteve gjendjet bankare sipas dokumentacionit të administruar nga sistemi bankar, si dhe deklaratimet cash sipas DPV-ve për vitet 2003 – 2016.

20.2 Analiza financiare, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ka rezultuar pozitive, në mjaftueshmëri financiare për pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit.

<sup>26</sup>Shihni pyetësonin e datës 7.10.2021.

<sup>27</sup>Shihni pyetësonin e datës 2.11.2021.

<sup>28</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>29</sup>Referojuni shkresës nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2022, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **Konkluzion për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në kohë dhe sipas ligjit, si dhe ka paraqitur në mënyrë të saktë dhe të plotë pasuritë dhe mjetet monetare të fituara prej tij dhe personave të lidhur. Nga kontrolli i pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe se ai ka pasur burime financiare të ligjshme dhe të mjaftueshme për krijimin e tyre.

Subjekti i rivlerësimit është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke dhënë në mënyrë të besueshme dhe shteruese informacionin e kërkuar.

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

21. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Në përfundim, DSIK-ja, në datën 26.10.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Etien Kapo.

22. Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësimin e informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit Etien Kapo, përderisa raporti pararendës kishte kryer verifikimet deri në datën 26.10.2017 dhe deklasifikimin e tij. Në vijim të verifikimeve nuk kanë rezultuar të dhëna për subjektin e rivlerësimit. DSIK-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.11.2021, ka deklasifikuar raportin për subjektin e rivlerësimit, duke konstatuar *përshatshmërinë* për vazhdimin e detyrës.

### **Konkluzione për kriterin e kontrollit të figurës**

Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të *përshatshëm* për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit Etien Kapo ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

23. Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLP-ja; kriteret e vlerësimit, të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; si dhe në denoncimet e paraqitura.

24. Nga analizimi dhe vlerësimi i tri dokumenteve të paraqitura nga subjekti dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura me short, rezulton se:

a) Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është argumentuar vendimmarrja për pushimin e procedimeve penale. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme mbi kontrollin e hetimeve në lidhje me çështjet me të pandehur të dërguara për gjykim. Po ashtu, konstatohet

se subjekti i rivlerësimit, prokurori Etien Kapo, në ushtrim të kompetencave të tij ka aftësi për të administruar dosjet.

b) Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Etien Kapo. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, në asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

c) Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokurori Etien Kapo, për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ka vlerësimin “shumë mirë”.

25. Nga verifikimi në arkivin e Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, konstatohet se me urdhrin nr. \*\*\*, datë 26.7.2002, të Prokurorit të Përgjithshëm, në atë periudhë të ushtrimit të detyrës, ndaj prokurorit Etien Kapo është dhënë masa disiplinore “vërejtje”<sup>30</sup>, pas një kontrolli të ushtruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

25.1 Ka rezultuar se nga Informacioni i Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit në kontrollet e ushtruara në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjatë ushtrimit të detyrës, subjekti ka kryer shkelje ligjore në hetimin dhe gjykimin e disa procedimeve penale të vitit 2001.

25.2 Masa disiplinore është dhënë në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 33, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”. Në pikën 4, të nenit 33, të këtij ligji, janë parashikuar edhe afatet kohore të vlefshmërisë së masave disiplinore, ku për masën “vërejtje” është parashikuar fshirja nga dosja personale, tre muaj nga data e dhënies së saj.

26. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020, ka konfirmuar se në emër të prokurorit Etien Kapo nuk ka procedim penal të regjistruar. Emri i prokurorit rezulton të jetë përmendur gjatë kryerjes së hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, i cili nuk ka emër të regjistruar në regjistrin e veprave penale. Pas kryerjes së hetimeve është vendosur pushimi i procedimit penal.

27. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020, ka konfirmuar se ka regjistruar kallëzimin penal nr. \*\*\*, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit I. S.. I dëmtuari I. S. ka pretenduar që hetimet ishin jo të plota dhe jo të orientuara drejt nga prokurori Etien Kapo, duke kërkuar fillimin e ndjekjes penale ndaj tij, për kryerje të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

27.1 Nga verifikimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se shtetasit I. S. dhe U. P. janë përfshirë në konflikt fizik me pasojë dëmtime të shtetasit I. S.. Në lidhje me konfliktin është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me hetimet e të cilit është ngarkuar prokurori Etien Kapo. Bazuar në aktekspertimin mjeko-ligjor nr. \*\*\*, datë 21.2.2018, është konstatuar se nuk ka dëmtime të jashtme trupore në trupin e shtetasit I. S.. Subjekti ka arsyetuar se fakti i ndodhur përmban elementet e veprës penale “dëmtime të tjera me dashje”, parashikuar nga neni 90/1<sup>31</sup> i Kodit Penal dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal sipas nenit 290/1/e duke e orientuar të dëmtuarin që në bazë të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale t’i drejtohej gjykatës me padi si i dëmtuar akuzues. Ky vendim i

<sup>30</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.9.2020, të Prokurorisë së Përgjithshme, bashkëlidhur së cilës gjendet urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr.\*\*\*, datë 26.7.2002, “Për dhënien masë disiplinore”.

<sup>31</sup>Neni 90/1 i Kodit Penal parashikon se: “Dëmtime të tjera me dashje – rrahja, si dhe çdo veprë tjetër dhune, përbën kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë”.

është njoftuar palës më 13.3.2018 dhe kallëzuesit i është dhënë e drejta që ta ankimojë në gjykatë.

27.2 Kundër vendimit për mosfillim procedimi datë 7.3.2018 shtetasi I. S. ka bërë kallëzim penal ndaj prokurorit, subjekt rivlerësimi, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, duke pretenduar se nuk ka kryer hetime për zbardhjen e çështjes.

27.3 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka konkluduar që vendimmarrja e prokurorit Etien Kapo ka qenë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe provat e administruara dhe me vendimin<sup>32</sup> datë 25.4.2018, “Për mosfillim procedimi penal” ka vendosur të mosfillojë procedimin penal për materialin kallëzues të shtetasit I. S..

#### **D. VLERËSIMI I DENONCIMEVE**

28. Në Komision kanë ardhur gjashtë denoncime për këtë subjekt rivlerësimi, të cilat janë analizuar në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni ka hetuar denoncimet duke vlerësuar edhe aktet përkatëse të përgatitura nga prokurori, si dhe në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij, për të cilat pas vlerësimit nuk u gjetën të dhëna, të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e aftësive të tij profesionale.

29. Nga verifikimi i të dhënave nga fakte të njohura botërisht (konkretisht, në emisionin investigativ “\*\*\*\*”<sup>33</sup>) informacion i njëjtë edhe me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2020, të shtetasit A. A. T., paraqitur në Komision, janë verifikuar informacionet në përputhje me nenin 53 të ligjit, nga ku rezultoi se:

a) Materialet procedurale janë regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 21.6.2019, ku nga shorti rezulton se dosja i kaloi për shqyrtim prokurorit, subjekt rivlerësimi.

b) Me vendimin e datës 5.7.2019, prokurori çështjes ka vendosur të mosfillojë<sup>34</sup> hetimet për procedimin penal lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\*, viti 2019, të shtetasit A. A. A., pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Mosfillimi i procedimit penal është vendosur brenda afateve ligjore.

c) Kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\* është ushtruar ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me vendimin nr. regj. themeltar \*\*\*, datë 18.11.2019, ka vendosur të pranojë kërkesën e kërkuarit dhe të shfuqizojë vendimin e organit të prokurorisë datë 5.7.2019, “Për mosfillimin e procedimit penal” lidhur me kallëzimin penal nr. \*\*\*, datë 21.6.2019.

ç) Nga verifikimi në faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Tiranë rezulton se çështja është ankimuar pranë kësaj gjykate me datë regjistrimi 23.12.2019 dhe nga verifikimi rezulton se statusi i çështjes është në përpunim.

29.1 Komisioni i ka kërkuar shpjegime nga subjekti i rivlerësimit, i cili shprehet se çështja është ende në shqyrtim gjyqësor, por sikundër rezulton nga aktet procedurale dhe nga jurisprudenca është aktekspertimi mjeko-ligjor, që përcakton pasojën për ato vepra penale që lidhen me nenin 290 të Kodit Penal. Që të konfigurimet vepra penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290 i Kodit Penal, kërkohet pasojë.

29.2 Trupi gjykues vlerëson se në zbatim të dispozitave të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, pika 2, *vlerësimi i aftësive profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.*

30. Në përfundim të vlerësimit mbi aftësitë profesionale, trupi gjykues vlerëson subjektin e rivlerësimit “*të aftë*” profesionalisht dhe arrin në konkluzionin se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë dhe është efektiv në punën e tij.

<sup>32</sup>Prokurorja ka arsyetuar se vendimet nuk mund të jenë objekt i ndjekjes penale (sipas frymës së vendimit nr. 11, datë 2.4.2008, të Gjykatës Kushtetuese).

<sup>33</sup>Emisioni “\*\*\*\*” dokumentoi një takim mes prokurorit Etien Kapo dhe qytetarit A. T.. Prokurori shpjegon se kemi të bëjmë me veprën penale të parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, “dëmtime të tjera me dashje”, e cila, bazuar në nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, është vepër që ndiqet me ankim të drejtpërdrejtë në gjykatë nga i dëmtuari nga vepra penale.

<sup>34</sup>Procedura hetimore prej momentit të regjistrimit të materialit kallëzues pranë organit të Prokurorisë më 21.6.2019 deri më 5.7.2019, kur prokurori, subjekt rivlerësimi, është shprehur me vendim për mosfillim procedimi, është realizuar brenda afatit 15-ditor të sanksionuar në nenin 291/1 të Kodit të Procedurës Penale.

31. Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Etien Kapo, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 13.5.2022.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*

ne detyre 16.03.1999														
ETIEN KAPO														
PROKUROR -PROKURORIA PRANE GJYKATES SE SHKALLES SE														
PARE TIRANE														
Monedha Leke														
	98-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>932.586</b>	<b>-54.524</b>	<b>602.787</b>	<b>247.443</b>	<b>10.861.890</b>	<b>547.557</b>	<b>730.536</b>	<b>199.517</b>	<b>59.070</b>	<b>63.600</b>	<b>183.847</b>	<b>-45.845</b>	<b>-73.525</b>	<b>-91.812</b>
Apartament 128.6 m2 , ****, blere me kontrate sh/bl ne 20.05.2013 ( 50%)					10.369.725									
Automjet ****- aktualisht me targje*****							2.006.920							
Rikonstruksion i pjesshem i sip. 23m2 i ballkonit te ap. ne ****						83.333	83.333	83.333	83.333	83.333	83.333			
Toke 970 m2 perfituar me dhurim date 13.11.1998 dhe dhuruar me kontrate date 23.01.2015														
Automjet **** ne emer te sr - shitur ne 18.05.2009	490.000						-685.850							
Automjet (ne emer te b/shortes) sjelle ne martese					556.664		-400.000							
<i>Shtesa/Pakesime likuiditete</i>	<i>442.586</i>	<i>(54.524)</i>	<i>602.787</i>	<i>247.443</i>	<i>(64.499)</i>	<i>464.223</i>	<i>(273.867)</i>	<i>116.184</i>	<i>(24.263)</i>	<i>(19.734)</i>	<i>100.514</i>	<i>(45.845)</i>	<i>(73.525)</i>	<i>(91.812)</i>
Likuiditete Gjendje	442.586	388.062	990.849	1.238.292	1.173.793	1.638.016	1.364.149	1.480.333	1.456.070	1.436.336	1.536.850	1.491.005	1.417.480	1.325.669
Cash ne Banese	-	-	200.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000	700.000
Likuidite Bankare	442.586	388.062	790.849	538.292	473.793	938.016	664.149	780.333	756.070	736.336	836.850	791.005	717.480	625.669
<b>DETYRIME</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>PASURINETO = Pasuri - Detyrime</b>	<b>932.586</b>	<b>-54.524</b>	<b>602.787</b>	<b>247.443</b>	<b>10.861.890</b>	<b>547.557</b>	<b>730.536</b>	<b>199.517</b>	<b>59.070</b>	<b>63.600</b>	<b>183.847</b>	<b>(45.845)</b>	<b>(73.525)</b>	<b>(91.812)</b>
	<b>98-2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>TE ARDHURA</b>	<b>2.773.225</b>	<b>932.434</b>	<b>1.016.195</b>	<b>1.040.267</b>	<b>12.428.260</b>	<b>1.751.579</b>	<b>1.864.377</b>	<b>1.834.134</b>	<b>1.739.663</b>	<b>1.874.415</b>	<b>1.918.135</b>	<b>2.410.547</b>	<b>2.282.399</b>	<b>2.330.534</b>
Te ardhura nga paga subjektit nga funksioni	2.773.225	929.502	1.011.132	1.031.087	903.635	936.281	1.066.117	1.092.800	1.136.753	1.058.386	1.053.755	1.231.936	1.273.522	1.286.484
Te ardhura nga paga b/shortja nga funksioni					678.323	678.744	791.869	734.512	598.602	812.299	850.608	1.030.459	1.007.864	1.043.280
Te ardhura nga paga b/shortja ne Universitetin****					0	0	0	0	0	0	10.086	71.903	0	0
Te ardhura nga paga b/shortja ne Universitetin****					0	0								
Rimbursim Trajnimi nga *****												68.749		
Interesat nga depozita ne USD		2.932	5.063	9.180	12.288	13.371	6.391	6.822	4.308	3.730	3.686	7.500	1.013	770
Prike nga b/shortja ( vlera e automjetit blere para martese)					556.664									
Dhurate nga babai i b/shortes					10.277.350	123.183								
<b>SHPENZIME</b>	<b>608.778</b>	<b>135.700</b>	<b>165.112</b>	<b>179.315</b>	<b>628.126</b>	<b>660.993</b>	<b>990.874</b>	<b>834.268</b>	<b>924.877</b>	<b>1.201.258</b>	<b>911.327</b>	<b>1.265.357</b>	<b>1.400.208</b>	<b>1.345.554</b>
Shpenzime jetese	608.778	93.964	109.557	109.557	409.860	409.860	409.860	409.860	546.480	558.192	564.096	879.992	897.104	940.368
Shpenzime Tims		41.736	-	14.203	12.711	45.578	475.459	318.853	272.842	537.511	241.676	335.365	453.104	355.186
Shpenzime arredimi					150.000	150.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000	50.000
Shpenzime te tjera etj			55.555	55.555	55.555	55.555	55.555	55.555	55.555	55.555	55.555			
<b>Rezultati= te ardhura - shpenzime - pasuri neto</b>	<b>1.231.861</b>	<b>851.258</b>	<b>248.296</b>	<b>613.509</b>	<b>938.245</b>	<b>543.029</b>	<b>142.967</b>	<b>800.349</b>	<b>755.716</b>	<b>609.558</b>	<b>822.961</b>	<b>1.191.035</b>	<b>955.716</b>	<b>1.076.791</b>